



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 1.2.2023

Nr: 22

Ora: 10:30

V E N D I M

P Ë R

ZBATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT ELEKTRONIK TË VOTAVE, NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023, NË BASHKITË ELBASAN, KAMËZ DHE VORË

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 1.2.2023 Nr: 22
Ora: 10:30



"Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, në bashkitë Elbasan, Kamëz dhe Vorë"